

VALBONA SKËNDERI (SHEHU)

Emri : Valbona

Mbiemri : Skënderi (Shehu)

Datëlindja: 01.03.1972

Kombësia : Shqiptare

Numri Telefoni: 0684083142

Email: yskenderi@ubt.edu.al

Znj. Valbona Shehu ka përfunduar arsimin e mesëm të përgjithshëm në vitin 1990. Në vitin 1995 ka përfunduar studimet e larta pranë Fakultetit të Ekonomisë Agrare në Universitetin Bujqësor të Tiranës, ku është diplomuar në degën Ekonomist. Formimin e saj akademik e ka thelluar më tej duke përfunduar studimet pasuniversitare Master në fushën e Agrobiznesit gjatë viteve 2004–2005. Gjithashtu, në vitet 2009–2010 është pajisur me dëshminë profesionale “Audit i Brendshëm” pranë Ministrisë së Financave, duke plotësuar kualifikimin e saj në fushën e kontrollit dhe menaxhimit financiar.

Eksperienca profesionale e Znj. Shehu nis në vitin 1996, ku gjatë periudhës janar–maj 1996 ka ushtruar detyrën e arkëtares në Fakultetin e Ekonomisë Agrare, Universiteti Bujqësor i Tiranës. Nga viti 1996 deri në vitin 1999 ka punuar si llogaritare në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës. Në periudhën prill 1999 – nëntor 2000 ka ushtruar detyrën e kryetares së degës së financës në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare.

Nga viti 2000 deri në vitin 2019, Znj. Shehu ka mbajtur pozicionin e Përgjegjëses së Sektorit të pagave dhe bursave në Universitetin Bujqësor të Tiranës, duke kontribuar për gati dy dekada në administrimin financiar. Në periudhën shtato 2019 – shkurt 2023 ka ushtruar detyrën e Përgjegjëses së Sektorit të menaxhimit ekonomik dhe financiar në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit. Që nga shkurti i vitit 2023, ajo vijon angazhimin e saj profesional si Administratore pranë Fakultetit të Mjekësisë Veterinare në Universitetin Bujqësor të Tiranës. Nga data 27.02.2025, Znj. Valbona Shehu është e ngarkuar edhe me detyrë shtesë si Administratore e Komanduar e Universitetit Bujqësor të Tiranës.

Me një eksperiencë profesionale mbi dy dekada në administratën universitare, Znj. Valbona Shehu zotëron njohuri të konsoliduara në menaxhimin financiar, kontrollin ekonomik, auditimin e brendshëm dhe administrimin institucional në arsimin e lartë.